

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikafloor®-200 Level

PËRBËRËS ME STRUKTURË TË LARTË, ME BAZË ÇIMENTOJE DHE I MODIFIKUAR ME POLIMERE PËR NIVELIMIN E DYSHEMESË. 3–40 MM

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikafloor®-200 Level është një përbërës me strukturë të lartë, çlirime shumë të ulëta, me bazë çimentoje dhe i modifikuar me polimere për nivelimin e dyshemesë. Ofron finiturë me tkurrje të reduktuar dhe të lëmuar për nëndyshemetë në mjedise të brendshme e të jashtme përpara aplikimit të veshjeve të dyshemeve.

PËRDORIMET

Formular për lëmimin dhe nivelimin e nëndyshemeve rezidenciale dhe jo-industriale në mjedise të brendshme dhe të jashtme përpara aplikimit:

- Dysheme druri
- Dysheme parketi
- Pllaka qeramike
- Pllaka guri
- Dysheme rrëshire pa bashkime
- Veshje tekstile për dyshemetë
- Veshje elastike për dyshemetë (linoleum, vinyl)

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- I vetënivelueshëm
- Trashësi shtrese: 3–40 mm. Deri në 60 mm me agregate
- I papërshkueshëm nga uji i ngjitesave me bazë uji
- I përshtatshëm për aplikim mbi sistemet e ngrohjes nën dysheme
- Tension / sforcim shumë i ulët mbi nënshtresë
- I pompueshëm
- I përshtatshëm për karriget me rrota të zyrave në përputhje me EN 12529
- I përshtatshëm si nënshtresë për ngjitjen e pllakave qeramike, i aplikuar mbi nënshtresa çimentoje

INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- VOC emission classification GEV-Emicode EC1PLUS, license number 6157/24.02.97

MIRATIME / STANDARDE

- Markë CE dhe Deklaratë Performance sipas EN 13813 - Llaç me bazë çimentoje për nivelimin e dyshemeve. Kategorija CT-C25-F6

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	me bazë çimentoje, i modifikuar me polimere
Ambalazhi	thes 25 kg
Paraqitja / Ngjyra	Pluhur gri
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin original, të pahapur dhe të padëmtuar në kushte të thata në temperatura midis +5 °C dhe +35 °C. Referohuni gjithmonë te ambalazhi.
Deklarata e produktit	EN 13813: Kategorija CT-C25-F6

Fleta e të dhënave të produktit

Sikafloor®-200 Level

Korrik 2020, Botimi 03.02

020815030010000152

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes	Koha 28 ditë	Temperatura +23 °C	Vlera ≥ 25 N/mm ²	(EN 13892-2)
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	Koha 28 ditë	Temperatura +23 °C	Vlera ≥ 6 N/mm ²	(EN 13892-2)
Reagimi ndaj zjarrit	A1 _{fl}			

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes	Sikafloor®-200 Level Sikafloor®-200 Level me agregate	~4,2–4,5 L ujë për 25 kg pluhur 16 kg ose 10 L rërë kuarci (0,1–3,0 mm) për 25 kg pluhur (~65 % për peshë) ≤ 4,5 L ujë për 25 kg pluhur										
Konsumimi	~1,8 kg/m ² /mm											
Trashësia e shtresës	Në kushte të zakonshme	Trashësia										
	Produkti											
	Sikafloor®-200 Level	3–40 mm										
	Sikafloor®-200 Level + agregate	10–60 mm										
	Llaç mastiku asfaltik (IC 10 dhe IC 15) (EN 13813)	3,0 – 5,0 mm										
	Në kushte të posaçme	Trashësia minimale										
	Kushtet											
	Ngarkesa e karrigeve me rrota të zyrave	Më shumë se 1 mm sipas EN 12529										
	Veshje me dysheme druri / parket	2,0 mm										
	Veshje me dysheme rrëshire	4,0 mm										
Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +30 °C max.											
Lagështia relative e ajrit	< 75 %											
Temperatura e nënshtresës	+5 °C min. / +30 °C max.											
Përgatitja e nënshtresës	<p>Kujdes: ⁽¹⁾ Nëse trashësia e shtresës së Sikafloor®-200 Level tejkalon 10 mm, lyeni nënshtresën e gipsit 2 herë me Sikafloor®-155 WN dhe spërkasni plotësisht me rërë kuarci (0,2–0,8 mm). Nëse Sikafloor®-155 WN nuk është spërkatur plotësisht me rërë, përdorni Sikafloor®-02 Primer përpara aplikimit të Sikafloor®-200 Level.</p> <p>Shënim: (1:3 ose 1:1) do të thotë hollim i prajmerit me ujë. Prajmer : Ujë</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nënshtresa</th> <th>Prajmer</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Nënshtresa me absorbueshmëri normale: beton, llaç çimentoje, llaç çimentoje me mpiksje të shpejtë</td> <td>Sikafloor®-01 Primer (1:3) ose Sikafloor®-03 Primer</td> </tr> <tr> <td>Nënshtresa gipsi ⁽¹⁾</td> <td>Sikafloor®-03 Primer ose Sikafloor®-01 Primer (1:1)</td> </tr> <tr> <td>Nënshtresa joabsorbuese: pllaka qeramike, mbetje ngjitësi me rezistencë ndaj ujit, shtresa rrëshire epokside dhe llaç mastiku asfaltik pa spërkatje të plotë</td> <td>Sikafloor®-02 Primer ose Sikafloor®-01 Primer</td> </tr> <tr> <td>Dysheme magnezi (jo xylolite)</td> <td>Sikafloor®-02 Primer</td> </tr> </tbody> </table>		Nënshtresa	Prajmer	Nënshtresa me absorbueshmëri normale: beton, llaç çimentoje, llaç çimentoje me mpiksje të shpejtë	Sikafloor®-01 Primer (1:3) ose Sikafloor®-03 Primer	Nënshtresa gipsi ⁽¹⁾	Sikafloor®-03 Primer ose Sikafloor®-01 Primer (1:1)	Nënshtresa joabsorbuese: pllaka qeramike, mbetje ngjitësi me rezistencë ndaj ujit, shtresa rrëshire epokside dhe llaç mastiku asfaltik pa spërkatje të plotë	Sikafloor®-02 Primer ose Sikafloor®-01 Primer	Dysheme magnezi (jo xylolite)	Sikafloor®-02 Primer
Nënshtresa	Prajmer											
Nënshtresa me absorbueshmëri normale: beton, llaç çimentoje, llaç çimentoje me mpiksje të shpejtë	Sikafloor®-01 Primer (1:3) ose Sikafloor®-03 Primer											
Nënshtresa gipsi ⁽¹⁾	Sikafloor®-03 Primer ose Sikafloor®-01 Primer (1:1)											
Nënshtresa joabsorbuese: pllaka qeramike, mbetje ngjitësi me rezistencë ndaj ujit, shtresa rrëshire epokside dhe llaç mastiku asfaltik pa spërkatje të plotë	Sikafloor®-02 Primer ose Sikafloor®-01 Primer											
Dysheme magnezi (jo xylolite)	Sikafloor®-02 Primer											
Koha e punueshmërisë	~40 minuta në +20 °C											
Koha e pritjes / mbiveshja	<p>Kujdes: Përpara aplikimit të veshjes së dyshemesë, sigurohuni se Sikafloor®-200 Level ka arritur vlerën e kërkuar me përmbytje lagështie, e</p>											

cila kërkohet nga prodhuesi i veshjes së mbulimit. (Lexoni skedën teknike të produktit të mbulimit).

Shënim: Kohët jepen me përafërsi dhe janë matur në +20 °C (ambienti) / +15 °C (nënshtrësja) / 65 % lagështi relative.

Shënim: Kohët e aplikimit do të ndikohen nga kushtet e ndryshueshme të nënshtrësës dhe ambientit, trashësia e shtresës dhe përmbajtje uji.

Sikafloor®-200 Level mund të mbulohet si më poshtë:

Mbulimi	Trashësi shtrese	Kohë pritjeje
Dru, pllaka qeramike, rrëshirë, tekstil, veshje elastike	≤ 5 mm	~24 orë
Dru, pllaka qeramike, rrëshirë, tekstil, veshje elastike	≤ 10 mm	~72 orë
Pllaka qeramike (dhe Sikafloor®-200 Level i aplikuar mbi nënshtrësë betoni ose çimentoje (mjedis i brendshëm)	≤ 60 mm	~4 orë

Produkti i aplikuar gati për përdorim

Shënim: Koha do të ndikohet nga kushtet e ndryshueshme të nënshtrësës dhe ambientit, trashësia e shtresës dhe përmbajtja me ujë.
Qarkullim këmbësorësh: ~4 orë

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Nënshtrësata e përshtatshme

- Beton
- Dysheme çimentoje
- Dysheme çimentoje me tharje të shpejtë
- Dysheme sulfati kalciumi
- Dysheme mastiku asfaltik (IC 10 dhe IC15) (EN 13813)
- Dysheme magnezi
- Pllaka qeramike
- Gur natyror

Cilësia e nënshtrësës

- Nënshtrësata me bazë çimentoje (beton / llaç) duhet të jenë të qëndrueshme. Riparoni pllakat qeramike ose gurët e thyer.
- Nënshtrësata duhet të jenë të pastra, të thata dhe pa ndotës si pislëqet, vaji, graso, bojërat, veshjet, ngjitësit që tretën në ujë dhe me rezistencë ndaj ujit, llaqet, trajtimet për sipërfaqe dhe materiali i lirë i shkrifët.
- Hiqni nënshtrësata e dobëta me bazë çimentoje ose prej mastiku asfaltik dhe shtresat niveluese.
- Hiqni shtresat ndarësi dhe shtresat me skorje.

Trajtimi paraprak

- Përgatisni mekanikisht nënshtrësata me bazë çimentoje, mastiku asfaltik, pllakat qeramike dhe gurin natyror duke përzgjedhur dhe përdorur pajisjen e përshtatshme për pastrim me rrymë abrazive, bluarje ose pajisje smerilizimi për llojin e nënshtrësës.
- Tekstura përfundimtare e nënshtrësës duhet të ketë teksturë të hapur me aftësi kapjeje.
- Defektet e sipërfaqes si vrimat dhe hapësirat duhet të ekspozohen plotësisht duke përdorur pajisjen e përgatitjes së sipërfaqes.
- Përdorni produkte nga seria e materialeve

Sikafloor®, Sikadur® dhe Sikagard® për nivelimin e sipërfaqes apo mbushjen e plasaritjeve, vrimave dhe hapësirave. Kontaktoni me shërbimin teknik për informacione shtesë mbi produktet e nivelimit dhe riparimit të defekteve.

- Produktet duhet të maturohen përpara aplikimit të Sikafloor®-200 Level.
- Dyshemeja ekzistuese prej mastiku asfaltik duhet të ketë teksturë të hapur pas përgatitjes dhe sipërfaqe të ashpër të spërkatur me rërë. Nëse sipërfaqja është e lëmuar (spërkatje e pamjaftueshme). Lyeni nënshtrësën me prajmerin Sikafloor®-02 Primer ose Sikafloor®-01 Primer i paholluar përpara aplikimit të Sikafloor®-200 Level. Aplikim vetëm për mjediset e brendshme.
- Izoloni çdo mbetje ngjitësi të tretshëm në ujë duke lyer dyshemenë me prajmerin Sikafloor®-155WN/-150/-151/-156/-160/-161 ose Sika® Primer MB Rapid dhe spërkasni plotësisht me rërë të thatë kuarci. Nëse nuk do të përdoret rërë kuarci, prajmeri izolues duhet të vishet me Sikafloor®-02 Primer përpara aplikimit të Sikafloor®-200 Level.
- Përdorni vakuum për të hequr pluhurin, materialet e lira dhe të shkrifëta nga sipërfaqja e aplikimit përpara shtrimit të produktit.
- Për të përmirësuar ngjitjen dhe për të ofruar një sipërfaqe pa pore për veshjet vijuese, përdorni Sikafloor®-01 Primer, Sikafloor®-02 Primer ose Sikafloor®-03 Primer.

Fleta e të dhënave të produktit

Sikafloor®-200 Level

Korrik 2020, Botimi 03.02

020815030010000152

BUILDING TRUST



PAJISJET

Përzgjidhni pajisjen më të përshtatshme për projektin:

Pajisja për përgatitjen e sipërfaqes

- Pajisje pastrimi me rrymë abrazive
- Retifikues
- Zdrugues
- Shkriftor
- Pajisje smerilizimi
- Pajisje industriale vakuumi

Për lloje të tjera pajisjeje të përgatitjes, kontaktoni me shërbimin teknik Sika.

Pajisja e përzierjes

- Mikser elektrik me 1 ose 2 lopata (<600 rpm) me helikë përzierjeje në formë disku
- Mistri
- Enë të pastra për përzierje

Për lloje të tjera pajisjeje për përzierjen, kontaktoni me shërbimin teknik Sika.

Pajisja e aplikimit

- Nivelues me gjemba
- Teh për sipërfaqen
- Krehër për shtrim dyshemeje
- Mallë nivelimi
- Rul me gjemba

Për llojet e pajisjes së pompimit, kontaktoni me shërbimin teknik Sika.

PËRZIERJA

Kujdes: Mos shtoni më shumë se 4,5 litra ujë për 25kg pluhur.

Kujdes: Mos përzieni me çimento të zakonshme Portland ose bindera (lidhës) të tjerë.

Kërkesë: Përdorni një mikser elektrik me një ose dy lopata (<600 rpm) me helikë në formë disku.

Pa spërkatje me agregate

1. Hidhni 4,2–4,5 L uji të pastër brenda një ene të pastër për përzierje.
2. Përzieni ngadalë ujin ndërsa jeni duke shtuar gradualisht të gjithë thesin me pluhur.
3. Përzieni vazhdimisht për të paktën 2 minuta për të arritur një miks homogjen. Nëse nevojitet, shtoni më shumë ujë për të arritur konsistencën e kërkuar.
4. Për të lejuar largimin e ajrit të bllokuar dhe për maturimin, mos përzieni për ~2 minuta.
5. Përzieni edhe për ~1 minutë.

Spërkatje me agregate

1. Hidhni 4,2–4,5 L uji të pastër brenda një ene të pastër për përzierje.
2. Përzieni ngadalë ujin ndërsa jeni duke shtuar gradualisht të gjithë thesin me pluhur.
3. Shtoni gradualisht 16 kg agregate.
4. Përzieni vazhdimisht për të paktën 2 minuta për të arritur një miks homogjen. Nëse nevojitet, shtoni më shumë ujë për të arritur konsistencën e kërkuar.
5. Për të lejuar largimin e ajrit të bllokuar dhe për maturimin, mos përzieni për ~2 minuta.
6. Përzieni edhe për ~1 minutë.

APLIKIMI

Kujdes: Ndiqni me kujdes procedurat e aplikimit, siç përcaktohen në Method Statements, manualët e aplikimit dhe udhëzimet e punimeve, të cilat duhet të adaptohen gjithmonë sipas kushteve aktuale në kantier.

Kujdes: Përpara aplikimit, konfirmoni përmbytjen e lagështisë së nënshtresës, lagështinë relative të ajrit, pikën e vesës, temperaturat e nënshtresës, ajrit dhe produktit.

Kujdes: Fugat e skajeve dhe të lëvizjes duhet të adaptohen në të njëjtin nivel me sipërfaqen e përfunduar dhe duhet të mbrohen në mënyrë që produkti të mos rrjedhë brenda fugës.

Kujdes: Produkti duhet të aplikohet në trashësinë dhe rrafshësinë e kërkuar e sipërfaqes, siç specifikohet nga prodhuesi i veshjes së dyshemesë.

Kujdes: Përdorni një shirit izolues për të parandaluar ngjitjen mbi sipërfaqet vertikale, ps.sh. tuba, mure, kolona, etj.

Kujdes: Për aplikimet në 2 shtresa, shtresa e dytë nuk duhet të tejkalojë trashësinë e shtresës së parë.

Kujdes: Për të reduktuar rrezikun e plasaritjes, mbroni produktin e freskët të aplikuar nga temperaturat e larta të ambientit, rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe rrymat e ajrit.

Shënim: Nëse në vend të mallës do të përdoret një nivelues-krehër, do të shmanget heqja e shenjave të mallës me rulin me gjemba ose nivelimi më shumë se një herë.

1. Derdhni produktin e përzierë mbi nënshtresë.
2. Përhapni produktin në mënyrë të njëtrajtshme duke përdorur një mallë nivelimi ose nivelues krëhër në thellësinë e kërkuar.
3. Lini produktin të nivelohet mbi nënshtresë.
4. Nëse duhet, kaloni menjëherë rulin me gjemba për të hequr shenjat e mallës ose defektet e sipërfaqes.
5. Nëse duhet të aplikohet një shtresë e 2-të Sikafloor®-200 Level, lyeni shtresën e 1-rë të ngurtësuar me prajmerin Sikafloor®-03 Primer ose Sikafloor®-01 Primer (i holluar me ujë 1:1).

Përgatitja e rekomanduar e sipërfaqes për dyshemenë me rrëshirë

1. Pas kohës së kërkuar të pritjes për Sikafloor®-200 Level, aplikoni me rul me çime, një veshje të dyfishtë prajmeri Sikafloor®-03 Primer.
2. Lini prajmerin të thahet dhe të mos jetë më ngjitës në prekje.
3. Aplikoni veshjen fillestare të Sikafloor®-151 + 2 % Extender T.
4. Inspektoni shtresën fillestare dhe mbushni poret me Sikafloor®-151 + 2 % Extender T.
5. Aplikoni produktin / sistemin e dyshemesë prej rrëshire.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni veglat menjëherë pas përdorimit me ujë. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Nëse produkti do të aplikohet në zona të jashtme apo të lagura, kërkohet aplikimi i një shtrese vijuese hidroizolimi të qëndrueshëm.
- Laçet e vjetër prej mastiku asfaltik IC10 dhe IC15 (EN 18813) zakonisht janë të plasaritur ose të thyeshëm. Kjo nënshtresë nuk paraqet rezistencë të mjaftueshme për të aplikuar përsipër laçin e vetënivelueshëm prej çimentoje me sforcim të ulët. Rekomandohet përdorimi i një llaçi me bazë gipsi i cili nuk ushtron sforcim.
- Të mos aplikohet mbi nënshtresa me lagështi në rritje. Nëse mund të ketë lagështi në rritje, duhet të aplikohet një membranë efikase kundër lagështisë në përputhje me standardin përkatës kombëtar.
- Udhëzimet e mëposhtme mund të ndihmojnë kur veshjet e dyshemesë mund të aplikohen mbi Sikafloor®-200 Level: Sipas rregulloreve gjermane, për aplikimin vijues të llaçeve me bazë çimentoje për dyshemetë, përqindja e lagështisë së përmbajtur të tij duhet të jetë $\leq 2,0$ CM-% (për llaçet që ngrohen $\leq 1,8$ CM-%). Llaçet e gipsit duhet të kenë lagështi të përmbajtur $\leq 0,5$ CM-% (për llaçet që ngrohen $\leq 0,3$ CM-%).

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikafloor®-200 Level
Korrik 2020, Botimi 03.02
020815030010000152

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdo lojë afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdo lojë forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sikafloor-200Level-sq-AL-(07-2020)-3-2.pdf